



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2330/1 prot.

Elbasan, më 27.09.2024

VENDIM
Nr. 46, datë 27.09.2024

Për

hapjen e Programit të studimit me karakter profesional në "Gjuhë angleze dhe italiane për teknologji dhe telekomunikim" në Departamentin e gjuhëve të huaja, Fakulteti i shkencave humane

Bazuar në nenin 3, pika 2, gërma "b"; nenin 35, pika 1, nenin 38, pika 1, gërma "dh"; nenin 75 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu IV/A, pika 3, gërma "b" të Udhëzimit të MASR-së nr.1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë, të ndryshuar, si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave Humane, si dhe në Vendimin e Senati Akademik nr. 5, datë 27.09.2024 "Për hapjen e Programit të studimit me karakter profesional në 'Gjuhë angleze dhe italiane për teknologji dhe telekomunikim'" në Departamentin e gjuhëve të huaja, Fakulteti i shkencave humane, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit me Karakter profesional në "Gjuhë angleze dhe italiane për teknologji dhe telekomunikim", në Fakultetin e Shkencave Humane të UE-së .
2. Burimi i financimit për këtë program studimi do të jetë tarifa e shkollimit për program dhe pa efekte financiare shtesë nga buxheti i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".
3. Ky vendim i përcillet Rektorit, Administratorit të UE-së dhe Fakultetit të Shkencave Humane. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Dr. Ardian Durmishi

